



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Lënda: Njoftim Publik

Data  
19.1.2021

**PËR: ZJ. EMILJANA MUHARREM SHEHI**

Nr. Protokolli

346

Me adresë të njohur: Vorrozen

Për dijeni: Këshillit të Bashkisë Kavajë

Adresa: Bulevardi "Josif Buda"

Për dijeni: Partisë G99

Adresa: Rruga e Durrësit, P.102, shk.3/24, Tiranë

Në Këshillin e Bashkisë Kavajë, është krijuar një vakancë, nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në kuadër të verifikimit të formularit të vetëdeklarimit, kërkon që kandidati i listës shumemërore të Partisë G99, me numër rendor 12, zj. Emiljana Muharrem Shehi, të depozitohet brenda 10 ditëve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Vendimit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Kreu II, paragrafi 3, parashikon se: "Në rastet kur procedura e kandidimit, zgjedhjes, apo emërimit për pozicionet dhe subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit, atëhere organi kompetent e njofton atë, që brenda 10 ditëve nga njoftimi, të depozitohet të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, sipas këtij vendimi, me përjashtim kur parashikohet ndryshe me ligj.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afrit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.



Kandidatit i është dërguar në adresën e njohur, njoftimi për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit. Nga njoftimi i postës, i kthyer në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se ky njoftim nuk i është dorëzuar, për arsye se ndodhet jashtë shteti (Itali).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidatit nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e tij. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Data e shpalljes së njoftimit ,mban datën e mësipërme në ditën e protokollimit të tij. Afati përfundimtar për dorëzimin, është 20 ditë nga data e shpalljes të këtij njoftimi.

Me afishimin e kësaj shpallje, kandidati është vënë në dijeni për njoftimin e saj për dorëzimin e formularit të vetedeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar me kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me kreun II, pika 7, dhe kreun III, pika 2, e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Sekretar i Përgjithshëm

**Ylli MERKAJ**

